



VENDIM

Nr. 75 Datë 24.08.2011

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY”
SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “a”; 9, dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “f” dhe 10, pika 1, të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, nenit 18, pikat 1, gërma “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.08.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.